



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
DREJTORIA E ARSIMIT SHËNDETËSISË, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 1/ 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 12, nenit 24, nenit 54, nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; *nenit 22, pika 2 të ligjit nr. 69/2012*, i ndryshuar “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 10 datë 28.02.2024 të Këshillit Bashkiak “ Miratimi i mbështetjes financiare për nxënësit me rezultate të larta në shkollat publike të Bashkisë Vorë”.

Bashkia Vorë, nëpërmjet dhënies së stimulit të nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë Vorë, synon të rrisë dëshirën për të mësuar, nivelin e tyre intelektual dhe mundësitë për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe sportive të komunitetit. Ky stimul gjithashtu synon zhvillimin e personalitetit të plotë të tyre, u krijon mundësi fëmijëve të gëzojnë në komunitet, të njohin e të ndajnë përparësitë shkencore dhe të përfitojnë prej tyre. Në këtë kuadër, Bashkia e Vorës, nëpërmjet këtij vendimi do të mbështesë çdo vit me bursa nxënësit e shkollave 9 -vjeçare dhe të mesme publike në Bashkinë Vorë, të cilët përfundojnë vitin shkollor me të gjitha 10(dhjeta).

Për përfitimin e mbështetjes financiare, nxënësit përfitues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 19.07.2024 pranë Drejtorisë së Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- a. Fotokopje të dëftesës së vitit shkollor.
- b. Vërtetim nga drejtorja e shkollës për vazhdimin e vitit shkollor.
- c. Çertifikate personale me fotografi e tre muajve të fundit.
- d. Çertifikatë e gjendjes familjare.